

**VENDIM**  
**Nr.29, datë 15.5.2006**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Emikel sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2005,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë Emikel sh.p.k. për vitin 2005.

2. Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Emikel sh.p.k. duke filluar nga data 18.5.2006, të funksionojë një grup pune për kryerjen e verifikimit të kostove dhe investimeve i përbërë nga:

- Lavdie Konjari, specialiste e Departamentit të Çmimeve dhe Tarifave,
- Embrin Kollçinaku, specialist i jashtëm i ERE-s,

- Eduard Elezi, Drejtori i Departamentit të Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,
- Fatbardha Mullahi, Drejtore e Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Pjetër Dema**